



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:150622
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05481605

C.nr.846/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Mirjeta Shala, në çështjen juridike të paditësit .Sh.a (K.), Bulevardi “.. nr.3 – Ndërtesa e Elektrokosovës, Kati II, nr.5 – Prishtinë-Distrikrit në Gjakovë, kundër të paditurit G.Z., nga Gjakova, rruga “..”, me objekt kontesti kompensim i demit material, jashtë seance më datën 22 qershor 2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET e tërhequr padia me numër C.nr.846/21 e ushtruar me datën 11.06.2021 e paditëses .K..S)-Prishtinë-Distrikrit në Gjakovë, kundër të paditurit G.Z., nga Gjakova, në çështjen juridike kompensim i demit material.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja , Sh.a (K.), Bulevardi “...”, nr.3 – Ndërtesa e Elektrokosovës, Kati II, nr.5 – Prishtinë-Distrikrit në Gjakovë, me datë 11.06.2021 në këtë gjykatë ka ushtrua padi kundër të paditurit G.Y., nga Gjakova, rruga “Ibrahim Femi”, me objekt kontesti kompensim i demit material,

Paditësja me parashtresën e datës 27.02.2023, ka bërë tërheqjen e padisë, me arsyetimin se i padituri e ka përmbushur detyrimin e tij ndaj paditëses duke paguar kështu vlerën prej 396.05 euro, në emër të kompensimit të demit material.

Sipas nenit 261 paragrafi 1 të LPK-së “*Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi*”, ndërsa në paragrafi 3 “*Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë*”. Nisur nga fakti se në rastin konkret i padituri ende nuk ka dhënë përgjigje në padi, gjykata erdhi në përfundim nuk ka qenë e nevojshme pëlqimi i të paditurit për tërheqjen e padisë nga ana e paditëses.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, konform nenit 261 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil-
C.nr.846/21, datë 22 qershor 2023

G j y q t a r j a,
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi në kuptim të nenit 261.4 të LPK-së, nuk lejohet ankesa.

Numri i lëndës: 2020:150622
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05481605